



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-06/01-11672/21 datë: 27.05.2021



Npi – 01/159 datë: 31.05.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2021, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 31.05.2021 (e hënë) në ora 14.00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Komitetit, z.Rahman Kadrija, Anëtarët: znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Brahimi, znj.Xhevahire Ramadani, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri, Nga OSBE z.Muharrem Haziri; Nga Zyra për Punësim, znj.Selvisha Bajrami; Nga Qendra për Punë Sociale, z.Burim Fazliu. Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Rahman Kadrija i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e kaluar më 30.04.2021
2. Informatë për risitë, kriteret dhe numrin e rasteve në skemën e asistencës sociale nga komuniteti ashkali dhe rom, (ftohet drejtori i QPS – Shtime)
3. Informatë për projektet e punësimit në zyrën e punës dhe punësimit, (ftohet drejtori i ZPP-së)
4. Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e kaluar më 30.04.2021

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e kaluar më 30.04.2021.**

Pika 2

Informatë për risitë, kriteret dhe numrin e rasteve në skemën e asistencës sociale nga komuniteti ashkali dhe rom, (ftohet drejtori i QPS – Shtime)

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrij; Fjalën ja dha Burim Fazliut.

z.Burim Fazliu, - QPS; Përshëndetje, në Qendrën për Punë Sociale në Shtime, sot kemi 381 përfitues të skemës sociale. Nga komuniteti ashkali i kemi 56 përfitues, ndërsa nga komuniteti rom e kemi 1 përfitues. Sa i përket pandemisë Kovid19 ne ju kemi dalë në ndihmë familjeve me pako ushqimore e higjienike. Po ashtu kemi ndihmuar me pako ushqimore familjet e prekura në kohën e vërshimeve që na kanë atakuar direkt.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Unë dua të pyes, nëse ka ndryshime në kriteret për përfitimin e skemës sociale?

z.Burim Fazliu, - QPS; Për momentin është ligji i vjetër në fuqi me kriteret e njejta që kanë qenë. Kemi dy kategori, kategoria e personave përfitues me probleme shëndetësore, dhe kategoria e përfituesve të skemës sociale me probleme ekonomike.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; E falënderoj Qendrën për Punë Sociale, sepse e kemi një bashkëpunim mjaft të mirë.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, çka ndodhë me personat që i mbushin 18 vjeq, a marrin ndihma sociale?

z.Burim Fazliu, - QPS; Personat që i mbushin 18 vjeq, bëhen të aftë për punë, dhe ligji ua ndalon skemën sociale.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, është mirë që ka një numër të përfituesve të skemës sociale, sepse në fshatin Gjyrkovc ne kemi pa që ka familje me kushte të vështira jetësore.

z.Burim Fazliu, - QPS; Është mjaftë sfiduese për ne qështja e skemave sociale që kanë të bëjnë me personat e moshës madhore, të cilët i kanë kushtet e vështira ekonomike. Mirëpo edhe në raste të tilla ku nuk u ka takuar ndihma sociale ne i kemi furnizuar me pako ushqimore dhe veshëmbathje.

Pika 3

Informatë për projektet e punësimit në zyrën e punës dhe punësimit, (ftohet drejtori i ZPP-së)

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrij; Fjalën ja dha Selvishahe Bajrami.

znj.Selvishahe Bajrami- ZPP; Përshëndetje, për momentin sot i kemi të evidentuar 2700 punëkërkuar. Zyra për punësim organizon praktikë për puntorët e ri në institucionet e republikës së Kosovës për me i aftësuar për tregun e punës. Tani unë nuk kam ndonjë raport të shkruar, por nëse ka ndonjë pyetje unë mund të përgjigjem.

z.Arton Demiri; Unë kam një pyetje se a ka ndonjë donacion për komunitetin Romë, që i përket ndihmave në profesionin e rrobaqepsisë?

znj.Selvishahe Bajrami- ZPP; Po ka mundësi me organizuar trajnime të tilla por dihet nëse pranon pronarja-i i biznesit.

z.Muhamet Ademaj; U tha se i kemi 2700 punëkërkuar, a mund të na thuani se sa prej tyre janë me fakultet? Këtu po e them për faktin se mendoj që do të ishte mirë për me e rrit numrin e nxënësve në shkollën profesionale me qëllim që të kemi kuadra që i përgjigjen tregut të punës.

znj.Selvishahe Bajrami- ZPP; Sektori i mobilerisë në Komunën tonë është mjaftë i zhvilluar, por ka mungesë të puntorëve të kualifikuar, prandaj edhe unë e përkrahu propozimin që duhet bashkëpunuar më shumë me shkollën profesionale me qëllim që të kemi kuadra që i përgjigjen tregut të punës.

z.Muhamet Ademaj; Vitin e kaluar psh. kemi pasë 25 nxënës në drejtimin e hotelierisë ndërkaqë sivjet i kemi 15 prej tyre. Unë mendoj se në këtë drejtim është dashur të kemi më shumë nxënës.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Dua të ju bëj një pyetje lidhur me personat e riatdhesuar, se a ka ende ndonjë projekt për integrimin e tyre?

znj.Selvishahe Bajrami- ZPP; Po, ka projekte por duhet me pas planin e biznesit, pastaj Kmisioni e bën vlersimin e tijë. Sigurisht që ata prap kanë të drejtë me aplikuar me të njejtin planë të biznesit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Unë mendojë se është koha e fuqizimit të zyrës së punsimit, të cilës duhet ti jepet rëndësi më shumë. Siç dihet zyra për punësim është e lidhur me aspektin e funksionimit të tregut të punës dhe nevoja për punë. Zyra e punësimit na ka ndihmuar neve si ZKKK-ë me projekte të caktuara, ku mundë të them se kemi pas një bashkëpunim mjaftë të mirë. Ne i kemi drejtuar palët në zyren e punësimit ku në shumicën e rasteve janë aprovuar kërkesat e tyre në zyrën e punësimit.

znj.Selvishahe Bajrami- ZPP; Unë kamë kërkuar edhe nga Kryetari që konkurset të vijnë edhe në zyrën e punësimit. Ne asnjëherë nuk e kemi marrë ndonjë konkurs nga Komuna, përveç se unë personalisht i kamë marrë dhe i kam publikuar, por kjo nuk ka ndodhë asnjëherë zyrtarisht. Ne jemi për bashkëpunim, por jemi edhe për ti pranuar kritikën. Siç e dini ne nuk jemi institucion që prodhojmë vende të punës, por vendet e lira të punës i bëjmë pubike për punëkërkesit, si dhe i këshillojmë ata për ndonjë punë të caktuar.

Pika 4

· Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Sa i përket kthimit dhe riatdhesimit në këtë periudhë kohore nuk kemi pas asnjë rast. Sa i përket ndërtimit të 6 shtëpive për komunitetin pakicë e të cilat kanë qenë në përfundim e sipër, tani nuk kemi ndonjë informatë se si qendron puna me to, mirëpo ne ende po vazhdojmë të paguajmë qira për 3 familje. Kemi hargjuar buxhet të ZKKK-së rreth 2000 euro ndërkaq që i kemi edhe 4500 euro, prej të cilave do ti japim prioritet kërkesave që janë më të nevojshme dhe më të domosdoshme. Nëse ka ndonjë pyetje jamë këtu për të ju përgjigjur.

znj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, a e keni publikuar ose a keni bërë ndonjë njoftim të posaçëm për regjistrimin e nxënësve në klasët e para për komunitetin pakicë?

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përveq njoftimit të përgjithshëm ne nuk kemi bërë ndonjë njoftim të veçantë.

z.Arton Demiri; Është një marrëveshje me OJQ-në “Katar” për hapjen e një pusi të përbashkët prej 70 metrave për 4 familje të komunitetit Romë në Shtime.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, unë propozojë që ti ndihmohet familjës së Shefki Osmanit, nga këto ndihma të parapara, ndërsa me i heqë nga pagesa e qirasë, këto 2 familje tjera. Sa i përket ndarjes së ndihmave unë propozojë që krejt stafi me u ndalë me i shqyrtu mundësit dhe me vendosë se a është ai personë për ti ndihmuar apo jo.

z.Arton Demiri; Unë po i lutem Ruzhdiut që me pasë konsideratë edhe për këta persona që duhet me ua pagu qiranë sepse edhe ata kanë nevojë .

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Elmi Jakupit duhet me i ndihmuar sepse e ka punën ashtu. E dimë që ai ka gabuar më herët që e ka shitë shtëpinë, mirpo tani ne nuk mundemi me e lënë në sokak.

z.Muhamet Ademaj; E falenderojë Ibrahim Demirin për angazhimin e tijë edhe për informatat që po na i sjellë. Ndjejë keqardhje që ende nuk kanë përfunduar këto 6 shtëpi për komunitetin pakicë, por shpresojë që së shpejti edhe këto të përfundojnë.

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ruzhdi Brahimi; Duke filluar prej lagjës së “Gashëve” në Shtime e deri te rrethi i fshatit Davidovc, kompanija “Pastërtia” nuk është duke i larguar mbeturinat që janë mbushur gjithandej, pyetja është pse nuk po i marrin këto mbeturina. Pastaj te bunari i “Milës” e kanë bërë deponi të mbeturinave, pse nuk po i largojnë këto mbeturina?

z.Arton Demiri; Meqënëse unë punojë aty, mundë të them se mbeturinat i marrin deri te lagjja e “Gashëve”, mirëpo ata e kanë ditën e caktuar se kur duhet ti marrin mbeturinat. Unë mundë të them se kemi problem mjaftë të madh për grumbullimin e mbeturinave për arsye se kamionat nuk po na punojnë aq mirë.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija mbledhjen e përfundoi në ora 15.20 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija

